

Shoqeria "Malido-Energji" shpk.
NIPT : K98824001D
Komuna Fan, Mirdite, Lezhe

Date 06/05/2022

VENDIM nr . 46

I Asamblese se ortakeve te shoqerise "Malido-Energji" shpk.

Asambleja e ortakeve te shoqerise "Malido-Energji" shpk e perbere nga shoqeria Koja shpk qe zoteron 53% te kuotave dhe shoqeria Malido shpk qe zoteron 47 % te kuotave .
Sot me daten 06/05/2022, ora 11:00 , ne mbledhjen e asamblesë së ortakëve të shoqërisë Malido-Energji shpk, u diskutua mbi hapjen e procedurave gjyqesore per perjashtimin e ortakut Malido shpk.

Shoqeria e shikon te arsyeshme hapjen e procedurave gjyqesore per perjashtimin e ortakut Malido shpk. Veprimet e ortakut Malido shpk dhe administratorit te saj z.Besnik Leka e bejne te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare te shoqerise Malido-Energji shpk.

Arsyet qe cojne ne kerkesen per perjashtimin e shoqerise Malido shpk, si ortak i shoqerise Malido-Energji shpk, jane si me poshte:

- Shoqeria Malido shpk nuk ka arketuar kapitalin qe i takon dhe si pasoje e mospermbushjes se ketij detyrimi, shoqeria Malido-Energji shpk ka vite qe paguan interesa dhe gjoba dhe ne te njejten kohe eshte ne proces permbarimor.
- Ortaku Koja shpk eshte demtuar rende si pasoje e mosarketimeve te kapitalit nga shoqeria Malido shpk.
- Ortaku Malido shpk ka demtuar turbinen nr.1 dhe gjithashtu ka demtuar bazamentin e turbinave ne godinen e HEC-it .
- Se fundmi ortakut Malido shpk ka bere shkarkimin e administratorit te shoqerise Malido-Energji shpk ne shkelje te statutit dhe detyrimeve te percaktuara ne ligj.

Nga votimi rezulton se:

Shoqeria Koja shpk (zoteruese te 53 % te kuotave) votoi pro, kurse shoqeria Malido shpk (zoteruese te 47 % te kuotave) ishte prezente ne fillim te mbledhjes por pas diskutimit te pikes se pare te rendit te dites u largua.

Duke qene se ortakut Malido shpk ka penguar ndjeshem veprimtarine tregtare te shoqerise Malido Energji shpk, asambleja e ortakeve te shoqerise Malido-Energji shpk bazuar ne ligjin nr.9901, date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, neni nr. 102, pika 1 dhe pika 2 germa a, germa b, germa c dhe germa ç

VENDOSI:

Per te ju drejtuar gjykates per perjashtimin e ortakut Malido shpk bazuar ne ligjin nr.9901 , date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, neni nr. 102, pika 1 dhe pika 2 germa a, germa b, germa c dhe germa ç .

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Per regjistrimin e ketij vendimi ne QKB ngarkohet administratori i shoqerise.

Ortaket e shoqerise Malido Energji shpk

Koja Shpk (53%)

Administratori

Lejlan Hajdari
[Signature]



Malido Shpk (47%)

Administratori

(U largua nga mbledhja)